



PROCESVERBAL I VII 2025

I mbajtur me rastin e mbledhjes së VIII (tetë) për vitin 2025 të Komitetit për Komunitete Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 18.08.2025
Ora : 09:00

Prezentë:

-znj.Melisa Shabanaj Kryesuese

z.Nazim Shabanaj

znj.Aferdita Morina

z.Zek Berisha

z.Aziz Bytyqi

znj.Dorentina Zenelaj

Të pranishëm tjerë:

Xheladin Sadikaj-Zyrtar për Kthim dhe Komunitete

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore

Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim

Përfaqësues i OSBE-së

Përfaqësues i LMT-së

Kryesuesja propozoi këtë rend dite

Rend Dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Veprimit Komunal për Strehim Familjar për Komunën e Suharekës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-31320**
- 4. Të ndryshme**

Kryesuesja- e hedhë në votim rendin e ditës

Unanimisht miratohet

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesja-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Veprimit Komunal për Strehim Familjar për Komunën e Suharekës;

Kryesuesja-e elaboron pikën dhe hap debatin

Avni Bytyqi-përshendetje për të gjithë ,po besojë që materialin e keni marrë në kohë dhe keni pas mundësi ta lexoni këtë plan veprimi për strehim familjar të Komunës së Suharekës për periudhën 2025-2027.Ky është obligim ligjor që del nga ligji për shërbime sociale dhe familjare që është miratuar në vitin 2024,Drejtorja e Shëndetësis ka organizu një grup punues të cilët kanë hartu këtë plan veprimi, në kuadër të këtij plani janë të parapara të gjitha aktivitetet që ka me i ndërmarrë Drejtoria përkatësisht Komuna për strehimin e Familjeve dhe atyre personave në nevojë,ky plan ka një periudhë afatmesme 3 vjeqare.

Kryesuesja-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-31320

Kryesuesja-e elaboron pikën dhe hap debatin

Avni Bytyqi-edhe ky ka të bëjë me një projekt-vendim të cilën e kemi dhënë në shfrytëzim një parcelë në rrugën Skenderbeu” në muajin Maj të këtij viti,Ministria e Pushtetit Lokal e ka kthyer në rishqyrtim dhe përshkak të kufizimit që jemi në periudhën e zgjedhjeve dhe kemi obligim nga momenti që Presidentja shpallë zgjedhjet deri në konstituimin e organeve të reja nuk kemi të drejtë për dhënjën në shfrytëzim të pronës publike dhe këtë vendim jemi duke e shfuqizuar.

Kryesuesja- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 4.Të ndryshme;

Kryesuesja-pasi që nuk ka debat,e mbyllë takimin

Takimi përfundoi: 9:10